



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 68/2 Prot.

Tiranë, më 15/12/2011

Lënda: Rekomandim për “Banka e Bashkuar e Shqipërisë” (UBA), Tiranë.

REKOMANDIM

Mbështetur në Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211 datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit “Banka e Bashkuar e Shqipërisë”, Tiranë.

KONSTATOVA

Në periudhën 20/10/2011- 05/12/2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit “Banka e Bashkuar e Shqipërisë”, Tiranë me objekt:

- Të dhënat personale që përpunohen (kategoritë e subjekteve, klientë, punonjës etj)
- Zbatimi i kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8, 9 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Si zbatohen të drejtat e subjekteve të të dhënave personale të parashikuara nga nenet 12, 13, 14, 15, 16, 17 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit në lidhje me të dhënat personale që përpunohen (neni 21).
- Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni 27).
- A përpunohen të dhëna personale nëpërmjet sistemeve të kamerave (CCTV), nëse ka tabela informuese?

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pasi shqyrtoi Proces-Verbalin mbi shkeljet e konstatuara gjatë kontrollit administrativ, si dhe provat e administruara, vëren se:

1. Kontrolluesi “Banka e Bashkuar e Shqipërisë”, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, mbledh dhe përpunon të dhëna personale sensitive lidhur me **kombësinë** dhe **gjendjen gjyqësore** për kategorinë e subjekteve të të dhënave “*klient*”.

Mbledhja, përpunimi i të dhënave personale sensitive mbi kombësinë dhe gjendjen gjyqësore të klientëve është e tepërt dhe jo proporcionale lidhur me qëllimin për të cilin ato mblidhen dhe përpunohen.

